

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë "DINASTY SYSTEM" Sh.p.k.

Sot, me datë 19 / 03 / 2024,

Z. Dritan Devole, shtetas shqiptar, lindur më 26.09.1970, në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 033869138 me ID H00926034K, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Znj. Enejda Alushaj, shtetase shqiptare, lindur më 05.10.1982, në Tiranë, mbajtëse e dokumentit kartë identiteti me nr. 034569998 me ID I26005062N, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Znj. Mirjeta Jakupi, shtetase shqiptare, lindur më 31.05.1981, në Tropoje, mbajtëse e dokumentit kartë identiteti me nr. 032795412 me ID I15521045A, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "DINASTY SYSTEM" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "DINASTY SYSTEM"

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Autostrada Tirane-Durres, Km 1, Rruga Ardeno, Godina nr 3, Tirane.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA



Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Import, eksport dhe prodhimin e sapunit, pluhurave lares dhe detergjente. Import, eksport dhe tregtim kimikate, dhe produkte pastrimi. Dezinfektim, deratizim dhe disinfektim. Import, eksport, tregtim hipoklorit natriumi dhe kalciumi, acid klorhidrik. Prodhimi sapunit, pluhurave lares dhe detergjente me material porositesi (fason). Poliklorur alumini dhe kimikate të tjera për trajtimin e ujit të pijshëm. Import-Export, tregtim plehrash kimike, import, export, tregtim kite dhe reagent, Import, export, tregtim të materialeve të pastrimit, kazana mbeturinash. Prodhim, tregtim dhe shërbime të ndryshme si larje, pastrim disinfektante për ambiente industriale, shtëpiake, publike, prodhim dhe tregtim maska mbrojtëse, xhel disinfektues për duar si dhe aerosol për disinfektim.



Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj në përputhje me legjislacionin në Shqipëri.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakeve themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 3 (tre) kuota.

Kapitali themeltar përbëhet si më poshtë:

Z. Dritan Devole, zoteron 1 kuotë, me 34% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 34.000 (tridhjetë e katër mijë) Lekë dhe 34.000 (tridhjetë e katër mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Znj. Enejda Alushaj, zoteron 1 kuotë, me 33% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 33.000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë dhe 33.000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Znj. Mirjeta Jakupi, zoteron 1 kuotë, me 33% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 33.000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë dhe 33.000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara në statut.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Dritan Devole**, shtetas shqiptar, lindur më 26.09.1970, në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 033869138 me ID H00926034K, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar; i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE


Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaket themelues të shoqërisë duke autorizuar Administratorin, **Z. Dritan Devole**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKET THEMELUES

Dritan Devole



Enejda Alushaj



Mirjeta Jakupi

